



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 437 Prot.

Tiranë, më 27.03.2023

V E N D I M

Nr. 42 , Datë 27 . 03. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën Nr. 145 regj, datë 20.09.2022, të paraqitur nga Fondacioni “Së bashku”³, përfaqësuar nga znj. Suela Lala, Drejtore Ekzekutive kundër Postës Shqiptare sh.a, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuar, që përfitojnë shërbimin në Zyrën e Postës Shqiptare sh.a, në Njësinë Administrative nr. 7, Bashkia Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon se, gjatë ushtrimit të veprimtarisë në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe takimeve të zhvilluara, kanë konstatuar problematika në lidhje me aksesueshmërinë në Zyrën e Postës Shqiptare sh.a. në Njësinë Administrative Nr. 7, Tiranë.

Pala ankuese parashtroi se, Zyra e Postës Shqiptare sh.a. në Njësinë Administrative nr. 7, Bashkia Tiranë, nuk është e aksesueshme dhe në hyrje të saj ka shkallë. Pala ankuese pretendon se, kjo vjen në kundërshtim me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe protokollin Opsional, ligjin nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”, VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Në vijim do t'i referohemi me “Pala ankuese”

përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbimet në Zyrën e Postës Shqiptare sh.a., në Njësinë Administrative Nr. 7, Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se : *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”*

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbimin në Zyrën e Postës Shqiptare sh.a, në Njësinë Administrative Nr.7, Tiranë.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, me numër të identifikimit të subjektit (NUIS) J61924007N, është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me aksioner të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.⁴ Objekti i aktivitetit të Postës Shqiptare sh.a. është: “Shërbime postare, financiare dhe bankare, aktiviteti i gjithë shërbimeve bazë të telekomunikacioneve dhe elektronike, botimi i gazetës “Postieri”, aktivitet radiofonik (“Radio Posta”), veprimtari biznesi, etj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Agjent në tregun e sigurimeve. Institucion i parasë elektronike.”

Posta Shqiptare sh.a. ofron shërbime publike dhe merr pjesë në sektorin publik. Posta Shqiptare sh.a. edhe pse është në pronësi të shtetit, nuk ushtron funksione, detyra apo kompetenca publike dhe nuk është pjesë e administratës publike. Në kuptim të nenit 7, të LMD, Posta Shqiptare sh.a. është një subjekt privat që ofron shërbime publike dhe jo një autoritet publik.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 1270/1 prot., datë 03.10.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Posta Shqiptare sh.a, në lidhje me pretendimet e parashtruara nga pala ankuese në ankesë lidhur me Zyrën e Postës Shqiptare sh.a. në Njësinë Administrative Nr. 7, Tiranë.

Posta Shqiptare sh.a, nuk ktheu përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion të Komisionerit.

2. Meqënëse Posta Shqiptare sh.a. nuk dërgoi parashtrime në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankesë, nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion për kërkesat e parashtruara nga Komisioneri, si dhe bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: “8. Kur e sheh

⁴ Referuar ekstraktit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB): www.qkb.gov.al.

të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri në datën 19.12.2022, zhvilloi një seancë dëgjimore publike.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesmarrjen e të dy palëve të përfshira në procedurën administrative, palës ankuese Fondacioni “Së bashku”, përfaqësuar nga znj. Suela Lala, Drejtore Ekzekutive dhe Posta Shqiptare sh.a., përfaqësuar me autorizim nga znj. A.K, specialiste e Sektorit të Çështjeve Ligjore.

Gjatë seancës dëgjimore, znj. Lala deklaroi se Zyra Postare në Njesisë Administrative Nr .7, Tiranë ka shkallë dhe nuk mund të aksesohet. Ajo deklaroi se merr vetë shërbime pranë kësaj zyre postare dhe si përdoruese e karrocës me rrota e ka të pamundur që të marrë shërbimet pranë kësaj zyre postare. Znj. Lala, theksoi gjithashtu se rëndësi për aksesin kanë edhe elementët e tjerë si, përparësia në radhë, shiritat për personat që nuk shikojnë apo sportelet e përshtatura dhe se ajo që synohet nga pala ankuese, është një reflektim nga Posta Shqiptare sh.a. në lidhje me cilësinë e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar.

Përfaqësuesja e Postës Shqiptare sh.a. deklaroi se nuk mund të jepte parashtrime, pasi nuk ishte njohur me ankesën. Komisioneri evidenton, se një pretendim i tillë është i pabazuar, pasi rezulton se Posta Shqiptare sh.a., ka marrë rregullisht dijeni për shkresën nr.1270/1 prot., datë 03.10.2022, nëpërmjet të cilës është njohur me ankesën dhe është kërkuar informacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ankesës.

Për t’i dhënë mundësinë Postës Shqiptare sh.a për të depozituar qëndrimin e saj në lidhje me ankesën, i’u la një afat kohor prej 10 ditësh për të depozituar pranë Komisionerit parashtrimet në lidhje me ankesën si dhe informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri me shkresën nr.1270/1 prot., datë 03.10.2022.

3. Me shkresën nr. 53 prot. datë 10.01.2023, Komisioneri rikërkoj nga Posta Shqiptare sh.a. që të depozitonte parashtrimet e saj dhe informacionin e kërkuar nëpërmjet shkresës nr. 1270/1 prot., datë 03.10.2022, pasi në vijim të seancës dëgjimore Posta Shqiptare sh.a. nuk ktheu asnjë përgjigje

Posta Shqiptare sh.a nuk ktheu përgjigje në lidhje me kërkesën e mësipërme për informacion.

4. Me *e-mail* datë 22.12.2022, pala ankuese depozitoi 3 fotografi të ambienteve të jashtme të Zyrës Postare objekt shqyrtimi si dhe një kronikë të realizuar nga Birn Albania në lidhje me me vështirësitë që personat me aftësi të kufizuara përballen për të aksesuar mjediset publike në Tiranë, publikuar në rretin social *Facebook* në datë 08.02.2022.⁵

⁵ <https://www.facebook.com/birinalbania/videos/344072804244317>.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe jo të barabartë.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Pala ankuese pretendon se mungesa e aksesueshmërisë në ambientet e Zyrës Postare në Njësinë Administrative Nr.7, Tiranë, një ambient ku ofron shërbimet e saj Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, diskriminon personat me aftësi të kufizuar të cilët për shkak të mungesës së aksesit, nuk mund të marrin në mënyrë të lirë dhe të pavarur shërbimet e ofruara nga ky subjekt.

Komisioneri konstaton se zyrat postare nuk korrespondojnë me njësitë administrative në qytetin e Tiranës. Bazuar në provat e administruara si dhe nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare në internet të Postës Shqiptare sh.a.⁶ rezultojnë se zyra postare objekt i ankesës, të cilën pala ankuese e ka identifikuar si Zyra Postare në Njësinë Administrative Nr. 7, Tiranë, i korrespondon Zyrës Postare Tirana 21.

Nga pamjet fotografike të vendosura në dispozicion nga pala ankuese rezultojnë se në hyrje në Zyrës Postare Tirana 21, ka shkallë dhe nuk janë vendosur instrumenta për të bërë të mundur eliminimin e pengesës që paraqesin shkallët për personat me aftësi të kufizuar që janë përdorues të karrocës me rrota apo që kanë vështirësi në lëvizje. Nga pamjet fotografike rezultojnë se mungojnë shiritat orientues për personat që nuk shikojnë. Pamjet e pasqyruara nga fotografitë e administruara përputhen me pamjet filmike të kronikës së publikuar nga Biri Albania, nga ku rezultojnë se pasqyrohen ambientet e jashtme të Zyrës Postare Tirana 21.

Posta Shqiptare sh.a. nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion në lidhje me përmbushjen e kriterëve teknike dhe parashikimeve në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë të parashikuar nga VKM Nr. 1503/2008 apo ndonjë planifikim për plotësimin e tyre në të ardhmen.

Kuadri ligjor i zbatueshëm

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁷, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së *“Për të Drejtat e*

⁶ <https://www.postashqiptare.al/rrejteti>.

⁷ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KDPK.

Personave me Aftësi të Kufizuara”⁸. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1).

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paaftësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës. (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë, aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga KDPAK si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

⁸Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: “2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun; b) për të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e arritshmërisë dhe shfrytëzimit për personat me aftësi të kufizuara; c) për të siguruar trajnim për pjesëmarrësit në proces lidhur me çështjet e heqjes së barrierave që ndeshin personat me aftësi të kufizuara;...”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.(në vijim ligji nr. 93/2014) Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.”

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesat e pavarur e personave me aftësi të kufizuara mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera ofrimin e shërbimeve. (neni 5/1)

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.(në vijim VKM nr. 1074/2015) Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohej pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm

si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat, përfshin si ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike. (Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008). Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

“PJESA I

Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike

Kreu I

Të përgjithshme

Neni 1

Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.

2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:

- të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

- godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;

- ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;

- ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.

Neni 2

Përshtatja e objekteve ekzistuese

1. Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe te llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.

2. Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t'u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.
3. Në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.
4. Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.

Neni 3

“19. Përpunimi relievor - është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes.

20. Vija relievore drejtuese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjerësi së paku 40 cm.

21. Vija relievore paralajmëruese - është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni.

22. Fusha relievore paralajmëruese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.”

Në nenet 18 dhe 19, të pjesës së parë të rregullores, parashikohet se, hapësirat e jashtme të ndërtesës dhe elementet përbërëse të tyre, si dhe sinjalistika, duhet të jetë e përshtatur sipas specifikimeve të parashikuara nga dispozitat respektive të rregullores (pikat 2 të nenit 4 dhe standardet e pikës 2 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje dhe rregullat e pikës 3 të nenit 4 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje), në mënyrë që të mund të jenë të arritshme nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

Në pjesën e dytë të rregullores, përcaktohen rregullat teknike dhe standardet për garantimin e mundësisë së hyrjes, përshtatshmërisë dhe fushpamjes në ndërtesa. Disa nga parashikimet e kësaj pjesë të rregullores janë si më poshtë:

“Kreu I

Të Përgjithshme

Neni 1

Fusha e aplikimit

Rregullat e përfshira më poshtë aplikohen në:

- ndërtesat private që ndërtohen të reja, rezidenciale ose jo;
- ndërtesat rezidenciale publike të financuara nga buxheti i shtetit, që ndërtohen të reja;
- ristrukturimet e ndërtesave private dhe publike;

- hapësirat e jashtme të ndërtesave të lartpërmendura në zonat e përcaktuara.

Kreu III

Zbatimi i rregullave

Neni 7

Zbatimi dhe shmangia nga rregullat

- 1. Standardet që përmban neni 8 në pjesën e dytë të kësaj rregulloreje, janë të detyrueshme për t'u zbatuar. Zgjidhjet teknike që përcaktohen në nenin 9 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje edhe pse nuk mbështeten në standardet e dhëna në këtë rregullore, janë të pranueshme nëse u përgjigjen kriterëve të projekteve të cilat plotësojnë rregullat nëpërmjet reduktimit të dimensioneve me zgjidhje të veçanta hapësinore ose teknologjike.*
- 2. Në projekt propozohen zgjidhje alternative për specifikimet dhe zgjidhjet teknike, që i përgjigjen kriterëve të projektimit. Në këtë rast çdo ndryshim duhet shoqëruar nga relacioni i ilustruar me grafikët e nevojshëm për të treguar alternativën e propozuar dhe ekuivalentin ose cilësinë më të mirë të rezultateve që rrjedhin nga zbatimi i tyre.*
- 3. Përputhshmëria e projektit me rregullat dhe standardet e dhëna në rregulloren e miratuar me këtë vendim dhe përshtatshmëria e zgjidhjeve të mundshme alternative certifikohen nga profesionistë të përgatitur pranë zyrave të kontrollit të projektit.*
- 4. Rregullat dhe standardet e këtij vendimi, janë të shmangshme vetëm për ndërtesat ose pjesë të tyre, të cilat në respektim të rregullave teknike specifike, nuk mund të realizohen pa pengesa arkitektonike, ose për vende të posaçme teknike në të cilat hyrja u rezervohet vetëm personave të specializuar.*
- 5. Në ndërhyrjet e ristrukturimit, lejohen shmangiet në rastin e pamundësisë teknike në lidhje me elementet strukturore dhe të impianteve, të cilat vërtetohen paraprakisht. Shmangiet lejohen vetëm nga autoritetet kompetente, përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.”*

Në Kreun IV, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohen standardet dhe zgjidhjet teknike të detyrueshme për t'u zbatuar me qëllim për të garantuar mundësinë e hyrjes dhe përshtatshmërinë e ndërtesave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Konkretisht në nenin 8, të VKM së sipërcituar, përcaktohen në mënyrë të detajuar standardet funksionale dhe të përmasave në ndërtesa, të detyrueshme për t'u respektuar.

Në nenet 16 dhe 21, të pjesës së dytë, të VKM nr.1503/2008, përcaktohen standardet teknike që duhet të plotësohen respektivisht, lidhur me vendosjen e telefonit, tekstofonit⁹ dhe bankomatit si dhe kushtet që duhet të plotësojë sporteli për personat me aftësi të kufizuar shfrytëzues të karrocave.

Sipas nenit 18, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, ndërtesat duhet të jenë të pajisura me një plan orientues sipas kriterëve të posaçme të parashikuara nga kjo dispozitë.

⁹ Referuar VKM nr.1503/2008, “tekstofon” - është telefon i përshtatur për persona që nuk dëgjojnë dhe/ose me dëgjim të dobësuar, që mundëson komunikimin me shkrim ndërmjet dy bashkëbiseduesve.

Kreu VI, i pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përmban rregullime lidhur me realizimin e rregullave për përshtatjen dhe shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Në nenin 30, të këtij kreu, parashikohet respektimi i elementëve lidhur me përshtatjen, sipas natyrës dhe qëllimit të objektit/ndërtesës. Në pikën 2, të nenit 30, përcaktohet ndër të tjera se:

“ Neni 30

Respektimi i elementeve të përshtatjes sipas natyrës dhe qëllimit të objektit

Ndërtesat publike, me destinacion për ushtrimin e një veprimtarie prodhuese, duhet të projektohen dhe të realizohen duke respektuar rregullat e standardet e përshtatjes të dhëna në pjesën e dytë të kësaj rregulloreje, në përputhje me qëllimin për të cilin ato ndërtohen sipas neneve përkatëse.

.....

2. Ndërtesat e postë telekomunikacioni:

- neni: 8 (pikat 2.1, dhe 2.9) për shërbime postare më pak se tre sportele ose aparat telefonik;
- nenet: 8 (pikat 2.1, dhe 2.9), 16 dhe 21 për ndërtime ku ofrohen shërbime telekomunikacioni dhe telefon, me tre ose më shumë pajisje.”

Në paragrafin e fundit të nenit 30, përcaktohet se: *“Përveç elementeve të përshtatjes në pjesët e objektit me destinacion kryerjen e veprimtarisë së biznesit, objekti për çdo pjesë tjetër të tij duhet të përshtatet me elementë sipas funksionit dhe detyrimisht përshtatjet sipas përcaktimit nga pika 1 - 15 të këtij neni.”*

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008 dhe bazuar në objektin e veprimtarisë tregtare të Postës Shqiptare sh.a, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, të cilat duhet të përmbushë ndërtesa ku ushtron veprimtarinë e saj Zyra Postare Tirana 21, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ndërtesa ku ofrohen shërbimet nga Zyra Postare Tirana 21, ka në hyrje të saj shkallë, të cilat përbëjnë pengesa infrastrukturore dhe nuk lejojnë personat me aftësi të kufizuara në lëvizje të cilët janë përdorues të karriges me rrota që të hyjnë në ndërtesë dhe të marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Ndërtesa ku ofrohen shërbimet nuk është e pajisur me rampë, që është një nga elementët e parashikuar për eliminimin e pengesave ose barrierave. Shkallët dhe mungesa e rampës, përbëjnë një burim vështirësie për lëvizjen e të gjithë atyre personave që kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar.

Komisioneri kërkoi informacion nga Posta Shqiptare sh.a. në lidhje me përmbushjen e të gjitha standarteve dhe kritereve teknike të parashikuara nga VKM nr. 1503/2008. Posta Shqiptare sh.a

nuk dha asnjë informacion në lidhje me plotësimin e standardeve teknike të detyrueshme për zbatim për ndërtesat që ofrojnë shërbime të postë telekomunikacionit, sikurëse ato që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a.

Referuar ekstraktit të Regjistrimit Tregtar, Posta Shqiptare sh.a, ka ndër të tjera si objekt të aktivitetit të saj, ofrimin e shërbimeve postare, financiare, bankare, ofrimin e shërbimeve bazë të telekomunikacioneve dhe elektronike, agjent në tregun e sigurimeve si dhe institucion i parasë elektronike. Nëpërmjet Postës Shqiptare sh.a ofrohen gjithashtu, shërbime të cilat kanë një efekt të drejtpërdrejtë tek personat me aftësi të kufizuara, siç janë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike. Pranë zyrës postare ofrohen edhe shërbime të tjera postare dhe financiare që prekin aspekte të ndryshme të jetës, të tilla si, tarifa shkollimi, pagesat e ujit, energjisë elektrike, si dhe pagesa për institucione të ndryshme shtetërore.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standartesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët nga shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a në Zyrën Postare Tirana 21. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në ndërtesën ku ofrohen shërbimet nga Posta Shqiptare sh.a, në Zyrën Postare Tirana 21, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet aksesimi për të marrë shërbimet e ofruara.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ndërtesa ku ushtron veprimtarinë Zyra Postare Tirana 21, pjesë e rrejtit të Postës Shqiptare sh.a, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Posta Shqiptare sh.a nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, në ofrimin e shërbimeve prej saj. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Tirana 21.

B. Shkaku i mbrojtur

Pala ankuese pretendon diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar të personave që përfitojnë shërbimin nga Posta Shqiptare sh.a pranë Zyrës Postare Tirana 21, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar.

Në nenin 1, të LMD, përcaktohet se: ***“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”***.

Referuar nenit 1, të LMD, shkak i diskriminimit “*aftësia e kufizuar*” i pretenduar nga pala ankuese, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllorja për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁰. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u

¹⁰ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹¹. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹². Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹³.

Është KDPAK e cila parashikon në nenin 9, të saj të drejtën për aksesueshmëri si një të drejtë më vete, përpos parashikimit të aksesueshmërisë si një nga parimet mbi bazën e të cilit duhet të interpretohen të gjithë të drejtat e tjera për personat me aftësi të kufizuara. KDPAK ndalon gjithashtu çdo formë diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, "diskriminimi" përkufizohet si: "*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*".

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet se ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: "*1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.*"

Në kreun IV, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht, në nenin 20, pika 1, të LMD parashikohet: "*1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*"

¹¹ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹² Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹³ Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

Parashikimet e bëra në pikën 2, të nenit 20, të LMD, janë orientuese dhe jo shteruese. Referuar objektit të veprimtarisë së ushtruar nga ana e Postës Shqiptare sh.a. të pasqyruar edhe në Regjistrin Tregtar, shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., si shërbimet postare, financiare, bankare, ofrimi i shërbimeve bazë të telekomunikacioneve dhe elektronike, apo veprimtaria si agjent në tregun e sigurimeve, si dhe institucion i parasë elektronike, janë shërbime të cilat ofrohen dhe janë të hapura për publikun në përgjithësi, të cilat hyjnë në fushën e veprimit të nenit 20, të LMD.

Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD. Bazuar në nenin 33 pika 7/1, të LMD, sanksionohet se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*.

Të njëjtin rregullim, në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Konkretisht, në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁴

Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Zyra Postare Tirana 21 nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin

¹⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar. Dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Tirana 21. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuar, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar që marrin shërbime pranë Zyrës Postare Tirana 21, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuar.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur që në rastin konkret është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i janë nënshkruar personat me aftësi të kufizuar, për shkak të mosrespektimit të standardeve të aksesueshmërisë të miratuar nga aktet në fuqi si më sipër janë cituar.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet se ka patur diskriminim, pra të diskriminimit *prima facie*. Rrjedhimisht, bazuar në standardit e provës, Posta Shqiptare sh.a. kishte barrën e provës që të provonte se trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuar që marrin shërbimet në Zyrën Postare Tirana 21, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Sipas KDPAK, edhe pse sigurimi i aksesit në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikimi dhe shërbimet e hapura për publikun është shpesh një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, sigurimi i aksesueshmërisë mund të arrihet përmes realizimit progresiv.

Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes, nga ana e subjekteve të detyruara, do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12). Sipas pikës 10, të kreut I, të VKM-së, parashikohet gjithashtu se: “Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë.”

Vendimi nr. 1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në pikat 9, 10, 13 dhe 14 të tij se : “9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. 10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të

nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.”

Realizimi progresiv do të thotë se heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: *“E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambientet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë”.*

Nëpërmjet disa vendimarrjeve të tij¹⁵, Komisioneri ka konstatuar mungesën e aksesueshmërisë në disa zyra postare ku ushtron veprimtarinë e saj Postën Shqiptare sh.a dhe ka kërkuar nga ky subjekt hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë. Komisioneri evidenton se, Posta Shqiptare sh.a nuk ka marrë asnjë masë në drejtim të sigurimit të aksesueshmërisë

Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuara, edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kështu që, vendosja e një rampe, nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi gjithashtu se, Posta Shqiptare sh.a. nuk ka marrë asnjë

¹⁵ Shiko: Vendimi nr.10, datë 21.01.2021, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/02/Vendim-nr.-10-date-21.01.2020-Fondacioni-Se-bashku-kunder-Postes-Shqiptare-sh.a-Diskriminim.pdf>; Vendimi nr. 111, datë 10.6.2022; Vendimi nr. 123, datë 23.6.2022, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/07/Vendim-nr.-111-date-10.06.2022-Fondacioni-Se-bashku-kunder-Postes-Shqiptare-sh.a-Diskriminim.pdf>, Vendimi nr. 115, datë 13.6.2022 <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/06/Vendim-nr.-115-date-13.06.2022-Shoqata-Se-Bashku-kunder-Zyres-Postare-Qender-Shijak-te-Postes-Shqiptare-sh.a.-Diskriminim.pdf>; Vendimi nr. 124, datë 20.6.2022, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/06/Vendim-nr.-124-date-20.06.2022-Fondacioni-Se-Bashku-kunder-Postes-Shqiptare-sh.a.-Diskriminim-ne-formen-e-rende.pdf>, Vendimi nr. 142, datë 19.7.2022, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/08/Vendim-nr.-142-date-19.07.2022-Fondacioni-Se-Bashku-kunder-Postes-Shqiptare-Diskriminim-ne-formen-e-rende.pdf>; Vendimi nr. 222, datë 20.12.2022, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/01/Vendim-nr.-222-date-20.12.2022-Fondacioni-Se-Bashku-kunder-Posta-Shqiptare-sh.a.-Diskriminim-ne-forme-e-rende.pdf>,

masë për të siguruar aksesueshmërinë për personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë ose me shikim apo dëgjim të kufizuar.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se Posta Shqiptare sh.a nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, sikurse kërkohet nga VKM nr. nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”* dhe është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Komisionerit nëpërmjet vendimeve të tij.

Për të siguruar aksesueshmërinë, KDPAK kërkon miratimin e disa standardeve minimale që duhet të përmbushen, standarde këto që rezultojnë të jenë miratuar, sikundër është parashtuar edhe më sipër në këtë vendim.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 *“Aksesueshmëria”*, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: *“Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara të diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar: (a) kur shërbimi ose objekti është krijuar pas miratimit të standarteve përkatëse të aksesueshmërisë.....”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Posta Shqiptare sh.a nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë provë, jo vetëm për të hedhur poshtë pretendimet e palës ankuese për mungesën e aksesueshmërisë në zyrën postare objekt shqyrtimi, por edhe për të provuar se kishte marrë ndonjë masë për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë, brenda afateve kohore të arsyeshme, në vendet ku ky subjekt ofron shërbimet e tij për publikun.

Komisioneri konstaton se, Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në ofrimin e shërbimeve nga ana e saj.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 *“Aksesueshmëria”*, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

“.....25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin

masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për përshtatjen e arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshëm është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: “duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integritetin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar¹⁶ dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t'u justifikuar¹⁷.”

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Tirana 21, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a. dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Tirana 21. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Neni 3/1 i LMD-së, ka përcaktuar se konsiderohet si formë e rëndë diskriminimi “çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit”.

¹⁶ Shih: Glor kundër Zvicrës, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

¹⁷ Shih: Guberina kundër Kroacisë, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

Komisioneri konstaton se:

- Posta Shqiptare sh.a ka kryer më shumë se një herë sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuar. Rezulton se, Posta Shqiptare sh.a, më shumë se një herë nuk ka garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke mohuar në këtë mënyrë aksesin e tyre në baza të barabarta me të tjerët, në marrjen e shërbimeve pranë disa zyrave të tjera postare ku Posta Shqiptare sh.a ushtron aktivitetin e saj (Zyra Postare Qendër Shkodër, Zyra Postare Qendër Durrës, Zyra Postare Hardhisht, Zyra Postare Sukth, Zyra Postare Qendër Shijak, Zyra Postare Ishëm, Zyra Postare Kamëz)
- Sjellja diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuar ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a, nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM nr.1503/2008, miratimin e VKM nr.1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe disa vendimarrjeve të Komisionerit, ku Posta Shqiptare sh.a është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria.

Bazuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ndaj personave me aftësi të kufizuar është konsumuar një formë e rëndë diskriminimi nga ana e Postës Shqiptare sh.a pasi përmbushen parashikimet e sipërcituara në nenin 3/1 të LMD-së.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të lmd, përcaktohet: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*.

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Posta Shqiptare sh.a. nuk kishte marrë masa për të siguruar standardet teknike të aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana

e Postës Shqiptare sh.a, i standarteve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Komisioneri evidenton ndër të tjera edhe nevojën për kryerjen e trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjëse nga ana e Postës Shqiptare sh.a., për të gjitha strukturat e saj, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në nenin 9/2/c, i KDPAK, rritja e ndërgjegjësimit lidhur me aksesueshmërinë, konsiderohet si një nga masat e duhura për eliminimin e pengesave/barrierave dhe garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Lloji dhe natyra e shërbimeve që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a., shërbime të cilat kanë ndikim në jetën e personave me aftësi të kufizuara, siç janë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike, kërkon me forcë marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në *formën e rëndë të tij*, të personave me aftësi të kufizuar, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Tirana 21.
2. Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa të menjëhershme për:
 - a. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Tirana 21, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”* dhe nr.1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”.
 - b. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

- c. Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.
3. Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.
 4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Posta Shqiptare sh.a., detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
 6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e Kufizuar
Fusha: Shërbime/Aksesueshmëri
Lloji i vendimit: Diskriminim në formën e rëndë